

Nr. 29/6 prot.

Korçë, më 27.01.2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT:**

"Punime ndërtimi për rikonstruksionin e godinave të stacioneve të pompave në fshatrat Vreshtas, Velitërnë, Kishnik (Podgorie), Shëngjergj dhe Plasë"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime ndërtimi për stacione pompash

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

3.473.577 (tremilionekatërqindeshatatëdhjetëetremijëepesëqindeshatatëdhjetëeshtatë) leke pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A (UKRK SH.A.) ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 ,me vlerë 69.471,54 (gjashtëdhjetëenëntëmijëekatërqinde shtatëdhjetëenjë presjepesëdhjetëekatër) lekë (2% të vlerës së përlogaritur të kontratës).*


K. Dishnica



I. Papa



Th. Koroveshi



**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8.*

c. *Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1.*

d. *Formulari Lista e Çmimeve sipas Zërave të Preventivit, sipas Shtojcës 2.*

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 1 389 430 lekë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet bazuar në dispozitat e sipërpërmendura ku përcaktohet:

Autoriteti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) **40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, si dhe sipas parashikimeve në nenin 43 dhe 55 të Rregullave të PP.**

**Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.**

Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Ajo i shërben UKRK Sh.A, për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës,

*Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

K. Dishnica

I. Papa

Th. Koroveshi

## 2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 1 042 073 lekë pa TVSH dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 3 473 577 lekë pa TVSH.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.


*(Shënim: të përcaktohen dokumentet konkrete që kërkohen për të dëshmuar përvojën e mëparshme të ngjashme me sektorin privat, të cilat janë të nevojshme dhe i shërbejnë AK për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.)*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, e nenin 55/4/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat **30% të vlerës** së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose të jenë minimalisht **sa vlera limit** e kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.


Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punë e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerat si më sipër, që janë brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor UKKO SH.A., për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.

I. Papa



Th. Korçoveshi



Shënim: (Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë MIE/ ose MPPT/ ose MTI, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

**a. NP – 2 A (Ndërtime civile dhe industriale)**

(Shënim: përcaktoni kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike , që ushtrojnë veprimtari ndërtimi.”, i ndryshuar.

(Shënim: përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor që parashikon licencimin në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit, kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

Kriteri lidhur me kategorinë e licencave profesionale , në fushën e zbatimit në ndërtim dhe nivelet e klasifikimit të kategorive është në përputhje me natyrën e kontratës dhe në përpjestim me volumet e punimeve.

Vendosja e këtij kriteri, që ndikon drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë , bazohet në:

- a. Tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet dhe vlerën limit të parashikuar;
- b. Zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe vlerat e parashikuara në secilin prej tyre në hartimin e fondit limit;
- c. Përshkrimin e veprimtarive konkrete të parashikuara për t’u realizuar në specifikimet teknike;
- d. Kategoritë e punimeve të zbatimit në ndërtim, përshkrimin e secilës prej tyre dhe vlerat në lekë që i përkasin klasifikimeve të specifikuara në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike , që ushtrojnë veprimtari ndërtimi.”, i ndryshuar;

I. Papa

Th. Koroveshi

Për :

**N.P – 2 A (Ndërtime civile dhe industriale)**

Niveli i klasifikimit korespondues është niveli “A” , i cili është për vlerë pune 0-20 milion lekë.

**N.P – 2 A (Ndërtime civile dhe industriale)**

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

Kategoria e kërkuar është kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, të preventivit , me vlerë totale 3.473.577 leke, pra brenda kategorisë A (0-20 milion leke).

2.2.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

**a. 1 (një) Inxhinier Hidroteknik ose 1 (një) Inxhinier Ndërtimi ;**

**Shënim:** Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr.8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë dokumentat provues :

*kontratë pune të vlefshme dhe diplomë.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne Ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe

I. Papa

Th. Koroveshi

disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierin Hidroteknik ose 1 (një) Inxhinier Ndertimi në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit.

*Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza profesionale e inxhinierit drejtues hidroteknik ose ndërtimi janë: F.V. Hekur betoni periodik Ø (6÷10) mm; Struktura monolite betoni C30/37; Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç i përzier M25; Hidroizolim me emulsiolin bitumi dhe 2 shtresa karton katrama; Çati vendi e zakonshme Hd~8m, tjegulla marseleze.*

*(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, nëse është rasti, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).*

2.2.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/ të kualifikuar**, si më poshtë:

- a. Një hidraulik
- b. Dy Karpentierë
- c. Një Saldator
- d. Dy Muratorë
- e. Dy Hekurkthyes
- f. Një Teknik të mesëm ndërtimi
- g. Një Hidroizolues
- h. Dy Bojaxhi /Suvaxhi
- i. Një shofer

**Shënim:** Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr.8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë dokumentat provues :

I. Papa

Th. Koroveshi

dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si dhe kontratat e punës të vlefshme ; për shoferin : leja e drejtimit dhe kontrata e punës.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne Ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Bazohet në përcaktimin ligjor që kritret duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Kërkesa për disponimin e një hidrauliku është vendosur sepse ky punonjës i kualifikuar do te sherbejne për montimin e ullukëve, për montimin dhe çmontimin e flanaxhave , saraqineskave dhe elementëve të tjerë hidraulikë gjatë zbatimit të punimeve. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 2 karpentierëve te cilet do te sherbejne per ndërtimin e kallëpeve të betonit dhe ndërtimin e konstruksionit të çatisë. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Kërkesa për disponimin e një saldatori është vendosur sepse ky punonjës i kualifikuar do te sherbejne për saldimin e profileve metalike për ralizimin e portës së rrethimit të stacionit të pompave. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 2 muratorë të cilët do te sherbejne per ndërtimin e mureve ndarëse në brendësi të godinave si dhe riparimin e pjesshëm të disa murave ekzistuese. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 2 hekurkthyesve te cilet do te sherbejne per vendosjen e armaturave të hekurit në punimet prej betoni të armuar në bazamentet e godinave te stacioneve. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e një tekniku të mesëm të ndërtimit për organizimin e punëve në kantier, si dhe për mbarëvajtjen e proceseve të punës. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Kërkesa për disponimin e një hidroizolues është vendosur sepse ky punonjës i kualifikuar do te sherbejne për realizimin e punimeve të hidroizolimit mbi soletat e godinave të stacioneve të pompave. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

I. Papa

Th. Koroveshi

Është vendosur kërkesa për disponimin e 2 punonjësve Bojaxhinj ose Suvaxhinj te cilet do te sherbejne per realizimin e shtresave të suvasë brenda dhe jashtë ndërtesave dhe lysterjen me bojë të tyre.. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e një shoferi i cili do te sherbejne per drejtimin e kamionçinës , për transportin e materialeve të ndërtimit .Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

2.2.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 14 persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Shënim:** Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr.8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë dokumentat provues :

*Listpagesat e sigurimeve shoqërore të konfirmuara nga organet tatimore, për periudhën kohore : Nëntor 2022 –Dhjetor 2022- Janar 2023, për punësimin e mesatarisht 14 personave”*

**Argumentimi:** Përcaktimi i numrit te punonjësve bazohet tek Ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore dhe tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës etj. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje Nëntor 2022 –Dhjetor 2022- Janar 2023 tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës.

Numri i punonjësve të kërkuar është vendosur minimalisht 14 persona sipas kriterëve me sipër:  
1 hidraulik + 2 Karpentierë + 1 Saldator + 2 Muratorë + 2 Hekurkthyes +1 Teknik i mesëm ndërtimi + 1 Hidroizolues + 2 Bojaxhi /Suvaxhi + 1 shofer+ 1 inxhinier = 14

I. Papa

Th. Koroveshi



Periodha kohore e listpagesave të sigurimeve shoqërore është përcaktuar periudha Nëntor 2022 – Dhjetor 2022- Janar 2023, në mënyrë që kriteri të përfshijë një periudhë sa më koherente.

Vlerësohet domosdoshmëria e stafit të punësuar për një periudhë të mëparshme, periudhën: Nëntor 2022 –Dhjetor 2022- Janar 2023, duke argumentuar se kjo shërben si tregues i një marrëdhënie të besueshme e të qëndrueshme midis punëdhënësit e punëmarrësit.

2.2.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Statusi	Sasia
Minifadrome me goma (bobcat apo ekuivalente)	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kamion me vinç	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kamionçinë deri në 6 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
Vibrator	në pronësi ose me qira	Copë 1
Gjenerator 15 kW	në pronësi ose me qira	Copë 1
Pompë për largimin e ujrave nga kanali me kapacitet mbi 10 l/s	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kompresor ajri	në pronësi ose me qira	Copë 1
Matrapik	në pronësi ose me qira	Copë 1
Autobetonere	në pronësi ose me qira	Copë 1
Saldatrice	në pronësi ose me qira	Copë 1
Helikopter për beton	në pronësi ose me qira	Copë 1

**Shënim:** Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr.8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorezojë pranë AK,

përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

I. Papa

Th. Koroveshi

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë dokumentat provues :

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (ivlefshëm).

Për mjetet e siguruar me qera duhet të paraqitet: a)dokumenti qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit, (I vlefshëm). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt I ketij prokurimi.

b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme targa e mjetit.

Autoriteti Kontraktor UKRK SH.A rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara nga OE.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Lloji dhe sasia e makinerive të kërkuara është përcaktuar në raport (në përpjestim) me punimet konkrete që do të kryhen, volumet e tyre dhe grafikun e punimeve.


(Shënim: përcaktoni aktin ligjor apo nënligjor, në bazë të të cilit është bërë përlllogaritja teknike e numrit të punonjësve dhe mjetet/makineritë/pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës)

2.2.8 Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certifikata te vlefshme:


- ISO 9001 ( Sistemi i menaxhimit të cilesisë) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë .
- ISO 45001 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi 2.4 :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rendësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë

I. Papa



Th. Koroveshi



veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001 (e vlefshme) për të garantuar kërkesat cilësore të materialeve të ndërtimit dhe punimeve të zbatimit.

Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001 (e vlefshme) për të garantuar rehabilitimin e plotë të sheshit të ndërtimit gjatë dhe pas kryerjes së punimeve me ndikime sa më të vogla në mjedis.

Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë OHSAS 18001 (e vlefshme) ose Çertifikatën ekuivalente të njohur nga Standardet shqiptare ISO 45001-2018 për të garantuar sigurinë e punëtorëve të zbatimit gjatë kryerjes së punimeve

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

**Bashkangjitur paraqitet Projekti i zbatimit i përbërë prej 8 faqe.**

**Bashkangjitur paraqiten specifikimet teknike, gjithësej 20 faqe.**

I. Papa

Th. Koroveshi

Nr.	Nr. An.	Emërtimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi (lekë)	Vlera (lekë)
I		<b>Stacioni i pompave Zvirinë për në Vreshtas</b>				
I.a		<b>Punime pastrimi dhe sistemimi për ambientin e jashtëm</b>				
1	3.1	Skarifikim bari me lopatë	m <sup>2</sup>	100.00		
2	3.2	Prerje bimë të vogla Ø<10 mm	m <sup>2</sup>	50.00		
I.b		<b>Punime të brendshme</b>				
1	An.1	Shtresë betoni C30/37 me pluhur kuarci e ilustruar me helikopter dhe e pajisur me nënshtresë polisteroli dhe armaturë hekuri Ø6 (15x15) cm, t=10 cm	m <sup>2</sup>	16.00		
2	2.166	F.V. Hekur betoni periodik Ø (6÷10) mm	ton	0.02		
3	3.248	Struktura monolite betoni C30/37	m <sup>3</sup>	0.25		
4	2.262/3	Shtresë betoni C12/15	m <sup>3</sup>	0.50		
5	2.267/a	Shtresë me pllaka grez porcelanato	m <sup>2</sup>	9.00		
6	2.310	Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç i përzier M25	m <sup>2</sup>	82.00		
7	2.300	Suva solete h~4m me drejtues, me krah	m <sup>2</sup>	26.00		
8	2.328	Patinim muri allçi (stuko)	m <sup>2</sup>	82.00		
9	2.330	Patinim tavani allçi (stuko)	m <sup>2</sup>	26.00		
10	2.404	Bojë hidroplastike (ngjyrë e bardhë)	m <sup>2</sup>	108.00		
11	4.109	Bojatisje mbi metal, pulverizim me alumin	m <sup>2</sup>	3.50		
I.c		<b>Punime të jashtme</b>				
1	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle h~8m	m <sup>2</sup>	73.00		
2	2.404	Bojë hidroplastike (ngjyrë limoni në jeshile)	m <sup>2</sup>	73.00		
3	2.264	Shtresë llustër çimento 1:2	m <sup>2</sup>	34.00		
4	2.203	Veshje kornizë me llamarinë xingato	m <sup>2</sup>	4.50		
5	2.197	Hidroizolim me emulsiion bitumi dhe 2 shtresa karton katrama	m <sup>2</sup>	34.00		

<b>I.d</b>		<b>Punime dyer dhe dritare</b>				
1	2.375/a	Dritare d/alumini dyfish xham	m <sup>2</sup>	3.60		
2	2.405	Pragje dritare me pllakë graniti të armuar me bojë	m <sup>2</sup>	1.00		
3	2.395/a	Derë d/alumini pa xham, me mbushje d/a	m <sup>2</sup>	2.70		
4	2.395/a	Dyer d/alumini dopio xham	m <sup>2</sup>	3.60		
		<b>SHUMA I</b>				
<b>II</b>		<b>Stacioni i pompave Zvirinë për në Velitërnë</b>				
<b>II.a</b>		<b>Punime pastrimi dhe sistemimi për ambientin e jashtëm</b>				
1	3.1	Skarifikim bari me lopatë	m <sup>2</sup>	100.00		
2	3.2	Prerje bimë të vogla Ø<10 mm	m <sup>2</sup>	50.00		
<b>II.b</b>		<b>Punime çatie</b>				
1	2.292	Trarë tavani të sharruar	m <sup>2</sup>	78.00		
2	2.219	Çati vendi e zakonshme Hd~8m, tjegulla marseleze	m <sup>2</sup>	78.00		
3	2.212/a	Ulluk shkarkimi horizontal me PVC 120 mm	ml	35.00		
4	2.209/a	Ulluk shkarkimi vertikal me PVC Ø120 mm	ml	18.00		
<b>II.c</b>		<b>Punime të brendshme</b>				
1	2.83	Mur me tulla nga me 4 vrima t=10 cm, h~3m, llaç përzier M15 (muri ndarës)	m <sup>3</sup>	1.47		
2	An.1	Shtresë betoni C30/37 me pluhur kuarci e ilustruar me helikopter dhe e pajisur me nënshtresë polisteroli dhe armaturë hekuri Ø6 (15x15) cm, t=10 cm	m <sup>2</sup>	29.00		
3	2.166	F.V. Hekur betoni periodik Ø (6÷10) mm	ton	0.05		
4	3.248	Struktura monolite betoni C30/37	m <sup>3</sup>	0.60		
5	2.262/3	Shtresë betoni C12/15	m <sup>3</sup>	0.35		
6	2.267/a	Shtresë me pllaka grez porcelanato	m <sup>2</sup>	6.50		
7	2.310	Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç i përzier M25	m <sup>2</sup>	135.00		
8	2.295	Tavan rjetë teli+suva	m <sup>2</sup>	78.00		

9	2.328	Patinim muri allçi (stuko)	m <sup>2</sup>	108.00		
10	2.330	Patinim tavani allçi (stuko)	m <sup>2</sup>	42.00		
10	2.404	Bojë hidroplastike (ngjyrë e bardhë)	m <sup>2</sup>	150.00		
11	4.109	Bojatisje mbi metal, pulverizim me alumin	m <sup>2</sup>	3.50		
<b>II.d</b>		<b>Punime të jashtme</b>				
1	2.64/2	Mur me tulla të plota në lartësi deri 3m me llaç të përzier M25	m <sup>3</sup>	2.00		
2	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle h~8m (Komplet muret jashtë dhe kabina elektrike)	m <sup>2</sup>	207.00		
3	2.404	Bojë hidroplastike (ngjyrë limoni në jeshile)	m <sup>2</sup>	207.00		
4	2.203	Veshje kornizë me llamarinë xingato	m <sup>2</sup>	2.00		
5	2.197	Hidroizolim me emulsiion bitumi dhe 2 shtresa karton katrama (Soleta e kabinës elektrike)	m <sup>2</sup>	9.20		
<b>II.e</b>		<b>Punime dyer dhe dritare</b>				
1	2.395/a	Derë d/alumini pa xham, me mbushje d/a	m <sup>2</sup>	4.80		
2	2.395/a	Dyer d/alumini dopio xham	m <sup>2</sup>	1.80		
3	2.390/1	F.V. dyer metalike me llamarinë të zezë 27,75 kg/m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	6.20		
4	2.375/a	Dritare d/alumini dyfish xham	m <sup>2</sup>	0.90		
		<b>SHUMA II</b>				
<b>III</b>		<b>Stacioni i pompave Shëngjergj</b>				
<b>III.a</b>		<b>Punime pastrimi dhe sistemimi për ambientin e jashtëm</b>				
1	3.1	Skarifikim bari me lopatë	m <sup>2</sup>	350.00		
2	3.2	Prerje bimë të vogla Ø<10 mm	m <sup>2</sup>	150.00		
<b>III.b</b>		<b>Punime të brendshme</b>				
1	2.262/3	Shtresë betoni C12/15	m <sup>3</sup>	0.55		
2	2.267/a	Shtresë me pllaka grez porcelanato	m <sup>2</sup>	28.00		
3	2.404	Bojë hidroplastike (ngjyrë e bardhë)	m <sup>2</sup>	143.00		
4	4.109	Bojatisje mbi metal, pulverizim me alumin	m <sup>2</sup>			

				5.12	
<b>III.c</b>		<b>Punime të jashtme</b>			
1	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle h~8m	m <sup>2</sup>	93.00	
2	2.404	Bojë hidroplatike (ngjyrë limoni në jeshile)	m <sup>2</sup>	93.00	
3	2.264	Shtresë llustër çimento 1:2	m <sup>2</sup>	47.00	
4	2.203	Veshje kornizë me llamarinë xingato	m <sup>2</sup>	4.50	
5	2.197	Hidroizolim me emulsioin bitumi dhe 2 shtresa karton katrama	m <sup>2</sup>	47.00	
		<b>SHUMA III</b>			
<b>IV</b>		<b>Stacioni i pompave Sheqeras (Brenda fshatit)</b>			
<b>IV.a</b>		<b>Punime të brendshme</b>			
1	An.1	Shtresë betoni C30/37 me pluhur kuarci e llustruar me helikopter dhe e pajisur me nënshtresë polisteroli dhe armaturë hekuri Ø6 (15x15) cm, t=10 cm	m <sup>2</sup>	19.40	
2	2.166	F.V. Hekur betoni periodik Ø (6÷10) mm	ton	0.05	
3	3.248	Struktura monolite betoni C30/37	m <sup>3</sup>	0.50	
4	2.262/3	Shtresë betoni C12/15	m <sup>3</sup>	7.40	
5	2.267/a	Shtresë me pllaka grez porcelanato	m <sup>2</sup>	7.40	
6	2.310	Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç i përzier M25	m <sup>2</sup>	87.00	
7	2.300	Suva solete h~4m me drejtues, me krah	m <sup>2</sup>	28.00	
8	2.328	Patinim muri allçi (stuko)	m <sup>2</sup>	87.00	
9	2.330	Patinim tavani allçi (stuko)	m <sup>2</sup>	28.00	
10	2.404	Bojë hidroplastike (ngjyrë e bardhë)	m <sup>2</sup>	115.00	
11	4.109	Bojatisje mbi metal, pulverizim me alumin	m <sup>2</sup>	3.50	
<b>IV.b</b>		<b>Punime të jashtme</b>			
1	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle h~8m	m <sup>2</sup>	72.00	
2	2.404	Bojë hidroplatike (ngjyrë limoni në jeshile)	m <sup>2</sup>	72.00	
3	2.264	Shtresë llustër çimento 1:2	m <sup>2</sup>		

				33.50	
4	2.203	Veshje kornizë me llamarinë xingato	m <sup>2</sup>	3.60	
5	2.197	Hidroizolim me emulsiolin bitumi dhe 2 shtresa karton katrama	m <sup>2</sup>	33.50	
<b>IV.c</b>		<b>Punime dyer dhe dritare</b>			
1	2.375/a	Dritare d/alumini dyfish xham	m <sup>2</sup>	3.85	
2	2.405	Pragje dritare me pllakë graniti të armuar me bojë	m <sup>2</sup>	1.35	
3	2.395/a	Derë d/alumini pa xham, me mbushje d/a	m <sup>2</sup>	1.56	
4	2.395/a	Dyer d/alumini dopio xham	m <sup>2</sup>	1.15	
		<b>SHUMA IV</b>			
<b>V</b>		<b>Stacioni i pompave Plasë (Për furnizimin e fshatit)</b>			
<b>V.a</b>		<b>Punime çatie</b>			
1	2.292	Trarë tavani të sharruar	m <sup>2</sup>	42.00	
2	2.219	Çati vendi e zakonshme Hd~8m, tjegulla marseleze	m <sup>2</sup>	42.00	
3	2.212/a	Ulluk shkarkimi horizontal me PVC 120 mm	ml	28.00	
4	2.209/a	Ulluk shkarkimi vertikal me PVC Ø120 mm	ml	10.50	
<b>V.b</b>		<b>Punime të brendshme</b>			
1	2.83	Mur me tulla nga me 4 vrima t=10 cm, h~3m, llaç përzier M15 (muri ndarës)	m <sup>3</sup>	1.50	
2	An.1	Shtresë betoni C30/37 me pluhur kuarci e ilustruar me helikopter dhe e pajisur me nënshtresë polisteroli dhe armaturë hekuri Ø6 (15x15) cm, t=10 cm	m <sup>2</sup>	23.30	
3	2.166	F.V. Hekur betoni periodik Ø (6÷10) mm	ton	0.03	
4	3.248	Struktura monolite betoni C30/37	m <sup>3</sup>	0.25	
5	2.262/3	Shtresë betoni C12/15	m <sup>3</sup>	9.60	
6	2.267/a	Shtresë me pllaka grez porcelanato	m <sup>2</sup>	9.60	
7	2.310	Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç i përzier M25	m <sup>2</sup>	83.00	
8	2.295	Tavan rjetë teli+suva	m <sup>2</sup>	36.00	
9	2.328	Patinim muri allçi (stuko)	m <sup>2</sup>		



				83.00		
10	2.330	Patinim tavani allçi (stuko)	m <sup>2</sup>	36.00		
10	2.404	Bojë hidroplastike (ngjyrë e bardhë)	m <sup>2</sup>	119.00		
11	4.109	Bojatisje mbi metal, pulverizim me alumin	m <sup>2</sup>	3.50		
<b>V.c</b>		<b>Punime të jashtme dhe rrethim (Rrjetë teli dhe portë metalike)</b>				
1	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle h~8m	m <sup>2</sup>	72.00		
2	2.404	Bojë hidroplastike (ngjyrë limoni në jeshile)	m <sup>2</sup>	72.00		
3	2.1	Gërmim dheu për profilet metalike	m <sup>3</sup>	3.00		
4	An.	F.V. Rrjetë teli Ø3 + Profile metalike	m <sup>2</sup>	147.00		
5	2.110/2	Beton C12/15 për themele	m <sup>3</sup>	0.50		
6	2.117/1	Kolona b/a (20x20x200)cm C16/20	m <sup>3</sup>	1.50		
7	2.182	Konstruksion metalike për portën	kg	100.00		
<b>V.d</b>		<b>Punime dyer dhe dritare</b>				
1	2.375/a	Dritare d/alumini dyfish xham	m <sup>2</sup>	2.50		
2	2.405	Pragje dritare me pllakë graniti të armuar me bojë	m <sup>2</sup>	0.60		
3	2.395/a	Derë d/alumini pa xham, me mbushje d/a	m <sup>2</sup>	2.00		
4	2.395/a	Dyer d/alumini dopio xham	m <sup>2</sup>	2.20		
		<b>SHUMA V</b>				
<b>VI</b>		<b>Punime H/Izolimi në stacionin e pompave Bulgarec</b>				
1	2.264	Shtresë llustër çimento 1:2	m <sup>2</sup>	70.00		
2	2.203	Veshje kornizë me llamarinë xingato	m <sup>2</sup>	6.12		
3	2.197	Hidroizolim me emulsioin bitumi dhe 2 shtresa karton katrama	m <sup>2</sup>	70.00		
		<b>SHUMA VI</b>				
		<b>SHUMA I+II+III+IV+V+VI</b>				
		<b>T.V.SH.</b>		<b>20.00%</b>		
		<b>TOTALI</b>				

Afatet e realizimit të punimeve: 56 ditë kalendarike

PUNIME NDËRTIMI PËR RIKONSTRUKSIONIN E GODINAVE TË STACIONEVE TË POMPAVE NË FSHATRA VRESHTAS, VELITERNË, KISHNIK (PODGORIE), SHËNGJERGJ DHE PLASË								
Përshkrimi i Punëve	Afati i realizimit							
	Java 1	Java 2	Java 3	Java 4	Java 5	Java 6	Java 7	Java 8
STP Zvirinë - Vreshtas								
STP Shëngjergj								
STP Sheqeras								
STP Bulgarec								
STP Zvirinë - Veliternë								
STP Plasë								

Ilir Papa (Inxhinier i DIT)

Thoma Koroveshi (Inxhinier hidroteknik)